

VENDIM
Nr. 346, datë 22.5.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 337, DATË 22.4.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË
KRYERJES SË PROCESIT TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-
NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në shkronjën “c”, të pikës 2, fjalët “... të cilët nuk kanë ndryshuar vendbanimin që prej kësaj datë ...” hiqen.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Familjet bujqësore ose individët, përdorues faktikë të tokës për veprimtari bujqësore, që kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991, gjendja civile e të cilëve u është transferuar në fshatin ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi, pas datës 1.8.1991, të cilët nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo pronësi në fshatin ku kanë pasur gjendjen civile më 1.8.1991 paraqesin në bashki:

a) kërkesën për pajisjen me AMTP për tokën që e kanë në përdorim faktik për veprimtari bujqësore;

b) planvendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim faktik, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët. Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të vet;

c) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e bashkisë, në datën e transferimit të gjendjes civile në fshatin ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi;

ç) dokumentacionin që vërteton se janë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991;

d) vërtetimet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, DAMT-ja dhe bashkia, ku kërkuksi ka pasur regjistrimin e gjendjes civile në datën 1.8.1991, se nuk është trajtuar me tokë në pronësi apo përdorim.

3/2. Familjet bujqësore ose individët, përdorues faktikë të tokës për veprimtari bujqësore, që nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi, sipas regjistrimit të gjendjes civile më 1.8.1991, por të mos kenë përfituar më parë tokë bujqësore në përdorim apo pronësi, paraqesin, në bashki:

a) kërkesën për pajisjen me AMTP për tokën që e kanë në përdorim faktik për veprimtari bujqësore;

b) planvendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët. Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të vet;

c) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e njësisë së qeverisjes vendore, sipas gjendjes më 1 gusht 1991, me ndryshimet deri më 1 tetor 1992, në fshatin ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi;

ç) vërtetimet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe DAMT-ja, në juridiksionin e të cilave gjendet toka bujqësore, se nuk është trajtuar me tokë në pronësi apo përdorim.”.

3. Në shkronjën “dh”, të pikës 11, fjalët “... vendimit nr.45, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore, të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ...”” zëvendësohen me “... legjislacionit në fuqi ...”.

4. Pas shkronjës “dh”, të pikës 11, shtohen shkronjat “e”, “p” dhe “g”, me këtë përmbajtje:

“e) Ministrisë përgjegjëse për ekonominë, të përcaktojë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse janë objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

f) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, DAMT-së dhe bashkisë, ku përdoruesi sipas pikës 3/1, të këtij vendimi, ka pasur regjistrimin e gjendjes civile më 1.8.1991, informacionin, nëse ky përdorues është trajtuar me tokë bujqësore në pronësi apo përdorim dhe në se kjo tokë është e regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme.

g) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe DAMT-së, në juridiksionin e të cilave gjendet toka bujqësore, ku përdoruesi sipas pikës 3/2, të këtij vendimi, ka pasur regjistrimin e gjendjes civile më 1.8.1991, informacionin nëse ky përdorues është trajtuar me tokë bujqësore, në pronësi apo përdorim, si dhe nëse kjo tokë është e regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme.”.

5. Kudo në tekstin e vendimit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) termi “komunë” hiqet;

b) emërtimi “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” zëvendësohet me “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”;

c) emërtimi “drejtoritë rajonale të bujqësisë” zëvendësohet me “agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor”;

ç) emërtimi “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës dhe agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama